

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Manipulimet - Farsat elektorale/ Rama premtan rritje pensionesh në prag të zgjedhjeve vendore
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916859/farsat-e-lektorale-rama-premtan-rritje-pensionesh-ne-prag-te-zgjedhjeve-vendore/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:11:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 16:40:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8e3e68d8239cb4a7a777853ee3e9e1bb5536012b13d1ea8e0f345c8e7c4989b
TEKSTI	0a34521efe834b2a73470b0ab83ec1c42a4ee68978a3740f3cf9187f89a8404a
PAMJA	794e023cbd1e8790bbea88b5b8039c7326b111e03e8ae39444388eb3f47a6294

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e35cddb40a99e026f62aacc3a3f93d792aa73a6389af7b67a08ab5a0f79fe71a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4768c0741a99d31c0c1ea2cb7e5bc9124f7af2f5dea963bef58ba2da55aae
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e35cddb40a99e026f62aacc3a3f93d792aa73a6389af7b67a08ab5a0f79fe71a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**
Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës**IRENA BEQIRAJ**
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

më të lexuarat

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

'Diaspora nuk ka për t'ia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto



Farsat elektorale/ Rama premton rritje pensionesh në prag të zgjedhjeve vendore

18:40, 15/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Qeveria njoftoi të martën se ka në plan të dyfishojë bonusin mujor për pensionistët duke nisur nga 1 janari 2027, në një kohë kur vendi bëhet gati për fushatën elektorale të zgjedhjeve vendore.

BIRN

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, në një video të shpërndarë në rrjetet sociale bëri të ditur se dyfishimi i bonusit mujor do të prekë të gjitha kategoritë e pensionistëve dhe se krahas kësaj do të vijojë edhe indeksimi i pensioneve.

Sipas ministres për financimin e kësaj mbështetjeje janë parashikuar 22.4 miliardë lekë më shumë në buxhet, ndërsa objektivi deri në vitin 2030 është që pensioni i plotë të arrijë në jo më pak se 40 mijë lekë dhe pensioni i pjesshëm në jo më pak se 22 mijë lekë.

"Ky është një angazhim konkret për të rritur, hap pas hapi, të ardhurat e pensionistëve deri në vitin 2030", tha Ibrahimaj, ndërsa koncepti i bonusit mujor u aplikua për herë të parë gjatë vitit 2026 për të zbutur pasojat e rritjes së çmimeve dhe varion nga 600 deri në 1,800 lekë në muaj sipas kategorisë së pensionit.

Nuk është hera e parë që qeveria Rama ka akorduar bonuse për pensionistët në prag të zgjedhjeve duke shkaktuar kritika për përdorim të financave publike për të influencuar votuesit.

Edhe ky premtime shihet me shqetësim si tentativë për të ndikuar në fushatën elektorale të 2027-ës.

"Bëhet fjalë për një vendim qeverie që korrespondon fiks në kufirin e periudhës 4 mujore përpara zgjedhjeve"- i tha BIRN, Rigels Xhemollari nga organizata Qëndresa Qytetare.

"Rritjen për shkak të inflacionit apo rritjen e merituar qeveria ua hedh si plaçkë elektorale një kontingjenti të madh qytetarësh, siç janë pensionistët, të cilët në nevojë të mëdha jetike bien pre e këtij karremi elektorale"- shtoi ai.

Pak muaj përpara zgjedhjeve parlamentare të 2025-ës, qeveria njoftoi shpërndarjen e dy bonuseve me vlerë nga 10 mijë deri në 15 mijë lekë për rreth 730 mijë pensionistë, me një kosto prej 163 milionë eurosh, vendim që u kritikua si tentativë për të orientuar votën e një prej kategorive më të mëdha të votuesve në vend.

Në raportet e vëzhgimit OSBE-ODIHR ka ngritur disa herë shqetësimin për përdorimin e burimeve publike për qëllime elektorale.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Ron Yeffet, ministër pa portofol', Bushkolaj: Përgjimet - Qeveria përdor 'punët e pista' për të rëmbyer bizneset



'Paratë janë marrë nga shteti', Lika: Qeveria i dha TIMAK Defense 900 milionë lekë paradhënie



NATO rikonfirmon angazhimin e palëkundur për sigurinë në Kosovë

Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimit prioritet

Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë

Shkërmoqen iluzionet e Erion Veliajt, mbetet në burg!

TË NGJASHME



VIDEO-Ekskluzive/ Këlliçi: Përmes Roni Yeffet, ushtria shqiptare është e furnizuar me teknologji dhe pajisje kineze




Mes protestave, qeveria forcon 'ministrinë' e propagandës dhe centralizon komunikimin



Sot protesta e 108-të kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh: Kryeministër jep dorëheqjen!



Sekserët e Ramës/ Vasili: Model mafioz - Skandali me përgjimet zbulon skemën si po grabiten asetet e shtetit



Komisioni i Ligjeve miraton ndryshimet ligjore për pagat e magistratëve



Berisha: Lufta kundër karteleve dhe mbrojtja e zgjedhjeve të lira, kryefjala e partneritetit me aleatët tanë amerikanë



SYRI TV/ Kroacia mbështet protestat në Tiranë, ambasadori kroat flet nga Pogradeci: Është mesazh për qeverinë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORTI JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.